



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

RAPORTI I KRYETARIT PËR GJASHTËMUJORIN E PARË 2021

Situata ekonomike/ financiare, siguria dhe gjendja pandemike në gjashtëmujoin e parë të vitit 2021

TABELA PËRMBAJTJES

I	HYRJE
1.1	
1.1.1	
II	ADMINISTRATË.....
2.1	
2.1.1	
2.1.2	
2.1.3	
2.1.4	
2.1.5	
III	BUXHET DHE FINANCA
3.1	
3.1.1	
3.1.2	
3.1.3	
IV	PROKURIM PUBLIK
4.1.1	
4.1.2	
V	EKONOMI, BUJQËSI, PYLLTARI
5.1.1	
5.1.2	
5.1.3	
VI	ARSIM, KULTUR, RINI DHE SPORT
6.1	
6.1.1	
6.1.2	

VII	SHËRBIME PUBLIKE, INSPEKSION, MBROJTJE DHE SHPËTIM.....	
7.1		
7.1.1		
6.1.2		
6.1.3		
VIII	SHËNDETËSI	
8.1		
8.1.1		
8.1.2		
8.1.3		
IX	URBANIZËM	
9.1		
9.1.1		
9.1.2		
X	SIGURIA	5
XI	SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE DHE BALLAFAQIMI ME PANDEMIN GLOBALE COVID-19	5
XII	PROJEKTET INVESTUESE	6
XI	TË TJERA.....	7

HYRJE

Raporti i punës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021, paraqet aktivitetet dhe veprimtarinë e zhvilluar të Komunës së Junikut në kuadër të realizimit të vizionit dhe mandatit kushtetues e ligjor, si njësi e qeverisjes lokale në ushtrimin e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një qeverisje të paanshme dhe pa dallime për të gjithë qytetarët.

Komuna me përkushtim respekton parimet e përgjithshme të Qeverisjes Lokale të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 123, për një qeverisje të mirë, transparente dhe efikase, në ofrimin e shërbimeve publike, gjithnjë duke respektuar Kartën Evropiane për Qeverisje Lokale.

Komuna në vijimësi mbetet në mbështetje të vizionit të saj, ku puna është e pandalshme për arritjen e standardeve dhe vlerave më të larta, integritetit, profesionalizmit, transparencës dhe llogaridhënies, ku përmes politikave zhvillimore dhe marrjes së vendimeve të rëndësishme të sigurojmë jetesën dhe mirëqenien e qytetarit.

Raporti paraqet situatën ekonomike/ financiare dhe realizimin e projekteve investuese për periudhën janar-qershor 2021, sipas Planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2021, i cili bazohet në Ligjin për Qeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës.

Ky raport përbëhet nga pjesë të standardizuara të realizimit të punëve gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2021, të cilat pasqyrojnë aspekte të veçanta për Komunën, kompetencat dhe bazën ligjore të funksionimit të Komunës, dhe aktivitetet të cilat paraqiten sipas drejtorive përkatëse dhe zyrave të cilat funksionojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit.

ADMINISTRATË

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka realizuar punën e saj në përputhje me Statutin e Komunës, Planin e Punës, ligjet, rregulloret, udhëzimet dhe vendimet në fuqi. Po ashtu, raporti në fjalë pasqyron edhe punë të tjera, që janë realizuar sipas nevojave të paraqitura gjatë procesit të punës.

Si një segment i rëndësishëm i Komunës, ku qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre kanë kontakte të drejtpërdrejta me pushtetin komunal po thuaj se çdo ditë, Administrata Komunale gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore (Janar – Qershor 2021), ka bërë përpjekje që të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, duke ju ofruar qytetarëve të saj, si në aspektin kohor dhe atë cilësor realizim të të drejtave të tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës, me kohë maksimale të pritjes 5 minuta, për të gjitha shërbimet që i ofron administrata. Në këtë drejtim fokusi ka qenë realizimi i synimeve programore, respektimi dhe zbatimi i ligjit si dhe akte të tjera juridike, të gjitha këto si parakushte për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase, gjithmonë në shërbim të përmbushjes së kërkesave individuale dhe të përgjithshme të qytetarëve, pa asnjë dallim. Këto synime sipas planit tonë të punës, dukshëm kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së përgjegjësisë në punë, disiplinë në punë, respektim të orarit, avancim të metodës së punës, transparencë dhe efikasitet në punë.

Në kontekst të kryerjes së shërbimeve që ofron Administrata e Përgjithshme, për këtë periudhë raportuese gjashtë mujore, ne nuk kemi pasur asnjë ankesë apo vërejtje nga qytetarët tanë, që do të thotë se sipas vlerësimit të përgjithshëm Administrata i ka përmbushë obligimet e saja të parapara me Planin e Punës dhe ligjet në fuqi, në mënyrë korrekte dhe cilësore karshi qytetarëve të saj, falë punës dhe angazhimit maksimal të të gjithë stafit punues, të cilët kanë ofruar shërbime efikase dhe të cilësisë së lartë, shërbime këto që ju përgjigjen qytetarëve dhe i përmbushin nevojat e tyre, edhe përkundër gjendjes së krijuar nga Pnademia COVID 19, që nga 13 Marsi 2021.

Janë duke vazhduar punimet në ndërtimin e Qendrës për Kulturë, Turizëm dhe Agrobiznes.

Është bërë raportimi në baza mujore, dhe varësisht nga kërkesat për institucione të ndryshme të Republikës së Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor 2021, në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme kanë qenë të angazhuar gjithsejtë 14 punëtor, prej tyre 1 Drejtor, 13 shërbyes civil në tre sektorë, dhe 2 punëtor (Mirëmbajtës I Objektivit të Administratës Komunale dhe Asistente Administrative) me kontratë me shërbime të veçanta, prej tyre në:

Sektorin për Administratë të përgjithshme, punojnë 8 punëtor,

Sektorin e Gjendjes Civile, 3 punëtor dhe

Sektorin për Protokoll dhe Arkiv 3 punëtor.

I gjithë stafi i Drejtorisë ka punuar bazuar në Planin Vjetor të Drejtorisë dhe ligjeve e rregulloreve që janë në fuqi, duke treguar rezultate të mira në punë.

Sektori i gjendjes civile ka qenë mjaft efikas dhe funksional në lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile dhe zhvillimin e procedurave administrative për rregullimin e çështjeve të gjendjes civile sipas kërkesave të palëve.

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë – Sektorit Pritës – Protokoll, ka qenë mjaftë efikase dhe funksionale në realizimin e lëndëve si të përfunduara.

Gjithashtu nivel i kënaqshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve ka qenë edhe në Drejtoritë e tjera të Administratës Komunale që me kohë kanë përfunduar – vendosur lëndët sipas kërkesave/parashtresave të qytetarëve.

BUXHET DHE FINANCA

Në kuadër të kësaj drejtorie fillimisht është përgatitur plani i punës për vitin 2021 në bashkëpunim me të gjithë stafin e kësaj drejtorie . Në fillim të vitit 2021 në Drejtorinë për Buxhetit dhe Financave kanë qenë të punësuar dhjetë zyrtarë dhe Drejtoresha.

Vlenë të ceket se me 1 Qershor është pranuar një praktikante e përzgjedhur dhe financuar nga Organizata Anibar në një afat kohorë prej tre muaj, dhe e cila është e vendosur në zyrën për Buxhet dhe Financa.

Drejtoria në përgjithësi operon me dhjetë punëtorë të ndarë në këto sektorë :

Sektori për buxhet

Sektori për financa

Sektori i tatimit në prone

Sektorin për Buxhet e përbejnë këta zyrtarë :Shefi i sektorit, Zyrtari shpenzues,Zyrtari Certifikues dhe Aprovues i shpenzimeve.

Sektorin për Financa përbejnë këta zyrtarë : ZKF, Zyrtari Zotues dhe Zyrtari për te hyra .

Sektorin për Tatim ne prone e përbejnë këta zyrtarë : Menaxheri i tatimit ne prone , Operatori për futjen e te dhënave, Anketuesi, Zyrtar për vlerësimin e pronës se paluajtshme, si dhe ne fillim te muajit Shtator është angazhuar me kontrate ne vepër edhe zyrtari Anketues pran zyrës se tatimit ne prone.

Të arriturat kryesore për këtë Drejtori gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit 2021 janë:

Sektori për Buxhet

Përpilimi i planit te punes nga te gjithe punetoret per vitin 2021.

Përpilimi i pasqyrave financiare te Komunës Junik për vitin 2020 dhe dorëzimi i tyre në MF pas barazimit të tyre me pasqyrat e free balancit .

Përgatitja dhe barazimi i raportit te shpenzimeve te vitit 2020, me MF – Thesar.

Përgatitja dhe barazimi i raportit tremoujor te shpenzimeve te vitit 2021, me MF – Thesar.

Përpilimi i planit të rrjedhës së parasë per vitin 2021 (cash flow) për të gjitha programet buxhetore të Komunës Junik në bashkëpunim me Drejtoritë tjera dhe dorëzimi i tyre në Thesar MF .

Autorizimet dhe delegimet e përgjegjësive për menaxhim dhe shpenzim te buxhetit , zyrtari zotues , zyrtaret autorizues, zyrtari certifikues,zyrtari i të hyrave – deponimi i nënshkrimeve ne Thesar.

Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujorit te pare dhe te dyte të shpenzimeve për te gjitha programet e Komunës për vitin 2021.

Përgatitja e raportit financiar te shpenzimeve për tre mujorin e paredhe te dyte për Komunën e Junikut për vitin 2021.

Përgatitja e Analizës se raporteve financiare për tremujorin e paredhe te dyte vitit 2021.

Përgatitja e raportit te punës për komplet drejtorinë për buxhet dhe financa për te gjitha sektorët për periudhën janar - qershor 2021.

Përgatitja e raportit sipas kodeve ekonomike për te gjitha programet e Komunës Junik për periudhën gjashtemujore 2021.

Përgatitja e Listës të borxheve Komunale ndaj subjekteve dhe operatoreve te ndryshëm ekonomik. Evidentimin dhe regjistrimin i te gjitha faturave te pranuar ne Komunën e Junikut dhe shpërndarja ne drejtoritë përkatëse

Regjistrimi i të gjitha alokimeve mujore buxhetore konform planit vjetor të rrjedhjes së parasë së gatshme.

Janë menaxhuar të gjitha lëvizjet e stafit në listat e pagave për të gjitha programet buxhetore komunale.

Regjistrimi i transfereve të ndryshme nga donatorët e jashtëm sipas marrëveshjeve te nënshkruara me Komunën e Junikut.

Nisja e procedurave per planifikimin e Buxhetit per vitin 2021/2023, pas pranimi te qarkores se pare Buxhetore 2021/01.

Perpilimi i KABI-it Komunal 2021/2023 per te gjitha programet buxhetore te Komunes Junik.

Sektori për Financa

Përgatitja dhe barazimi i raportit të hyrave për vitin 2020 ne MF – Thesar.

Regjistrimi i të gjitha të hyrave komunale në sistemin e free balancit nga të gjitha programet si psh: (Administrata, Buxhet dhe Financa , Urbanizëm, Shëndetësi, Shërbimet Publike, Zhvillim Ekonomik) varësisht nga llojet e të hyrave dhe po ashtu barazimet mujore dhe alokimet e të hyrave vetanake te cilat janë bërë ne Thesar – MF, për vitin 2021.

Përgatitja e raporteve mujore, tremujore dhe gjashtemujore te të hyrave për te gjitha programet e Komunës për vitin 2021.

Zotimi i mjeteve për të gjitha programet e Komunës Junik sipas kërkesave të Drejtorive,

Çertifikimin dhe aprovimin e të gjitha lëndëve për pagesa të ndryshme.

Shpenzimi i lendeve gjate periudhes Jajar-Qershor 2021.

Gjate kesaj periudhe gjashtemujore, ne sistemin e Free Balancit jane Bere shpenzim keto lende ne keto module:

Moduli i Blerejes gjithsejte 107 lende, ndersa
Moduli i Aprovimit 364 lende.

Sektori i Tatimit në Pronë

Gjatë tre mujorit të dytë të viti 2021 Zyra e Tatimit në Pronë ka qenë e gatshme gjithmonë për shërbime ndajë qytetaret, për sqarime dhe konsultime të ndryshme në bazë nevojave që janë paraqitur.

Kemi lëshuar vërtetime për kryerjen e obligimeve siç janë :

Vërtetime për regjistrim automjeteve

Vërtetime për Gjeodezi dhe Kadastër

Vërtetime për Çertifikat Vendbanimit

Vërtetime për Subvencionime

Vërtetimeve për rregullimin e dokumentacioneve të ndryshëm, ku të gjitha janë lëshuar nga sistemi me funksionin „shtype certifikatën e pagesë, ku gjithsej janë 321 vërtetime, gjithashtu kemi lëshuar dhe 5 vërtetime për jo tatimpagues të cilët nuk kanë prone të regjistruar në programin e tatimit PROTAX.

Po ashtu është bërë edhe verifikimi i bizneseve që operojnë në Komunën e Junikut.

Gjithashtu gjatë muajit Shkurt kemi ndryshuar pikat e lokacioneve të ato Objekte të cilat kanë qenë gabim mbi 240 pika si dhe kemi shpërndarë faturat e tatimit në pronë .

ZHVILLIMI EKONOMIK

Raporti pasqyron aktivitetet e punëve që janë ndërmarr gjatë periudhës vjetore të vitit 2021 deri më 31.06.2021 në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, në përputhje me planin e punës dhe sipas nevojave të paraqitura gjatë procesit të punës.

Në kuadër të kësaj drejtorie fillimisht është përgatitur plani i punës për vitin 2021 në bashkëpunim me të gjithë stafin e kësaj drejtorie.

Stafi i angazhuar në këtë Drejtori përbëhet nga :

1. Drejtori për Zhvillim Ekonomik

2. Zyrtares për zhvillim ekonomik (Zyrtar alternativ edhe për Biznese dhe Turizëm)

3. Zyrtares për bujqësi dhe zhvillim rural

4. Zyrtares për pylltari

5. Roje të pyllit (1 Person)

Me datën 22.08.2013 është bërë bartja e kompetencave për mbrojtjen e pyjeve me ç'rast janë transferuar stafi i pylltarisë gjithsejtë 6 zyrtarë bazuar në Ligjin nr. 04/L-086 për Parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", Vendimin e Ministrit të MMPH me nr. 04/2013 i datës 11.02.2013, Memorandumit për transferimin e kompetencave për mbrojtjen e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" si dhe Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv nr. 304/AMMK/2013 të datës 16.08.2013.

Drejtoria pas bartjes së këtyre punëtorëve në përgjithësi operon me 6 punëtorë të ndarë në dy sektorë funksional :

- Sektori për Zhvillim strategjik dhe Turizëm

- Sektori për Bujqësi dhe Pylltari

Aktivitetet e kryera gjatë periudhës vjetore të vitit 2021 të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik kryesisht kanë qenë të orientuara në :

- Strukturimin e stafit

- Njoftimi me punët që duhet të kryhen gjatë vitit 2021 dhe

- Aktivitete tjera të parapara sipas vendit të punës dhe nevojave të dala gjatë procesit të punës.

Drejtori i Drejtorisë gjatë kësaj faze ka kryer këto aktivitete:

☐ Kompletimi dhe Sistemimi i stafit të drejtorisë

☐ Menaxhimi dhe koordinimi i punëve dhe i stafit

☐ Bashkëpunimi me Kryetarin, Drejtorët e drejtorive dhe koordinimi i punëve në mes të drejtorive.

☐ Takime të ndryshme me donatorë të mundshëm që operojnë në Kosovë dhe jashtë Kosovës:

- KFOR-i italian (CIMIC) për mundësitë e mbështetjes financiare për projekte të ndryshme, kemi kërkuar mbështetje për financim të projekteve të Kanaleve të Ujitjes dhe projekte tjera mirëpo këtë vit nuk është financuar ndonjë projekt nga KFOR-i.

- Meqenëse zhvillimi i sektorit të Bujqësisë është prioritet për Komunën e Junikut, drejtoria për zhvillim ekonomik ka vazhduar me implementimin e Projektit për ndërtimin e Kanaleve të Ujitjes me gjatësi prej 1.1 km. Ky projekt ka filluar me mjete vetanake të Komunës dhe është projekt dy-vjeçar dhe vlera totale e projektit ka kapur shumën 56,000.00 Euro.

- Drejtoria për zhvillim Ekonomik gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit 2021 për shkaqe të pandemisë COVID 19, ka anuluar të gjitha aktivitetet tradicionale me qëllim të promovimit të vlerave turistike siç është "Dita e Gështënjes", Gara me Bicikleta "Downhill Gjeravica 2021", etj.

- Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka vazhduar bashkëpunimin me organizatën me famë Botërore "YMCA", organizatë kjo që po vazhdon aktivitetet e saja me të rinjtë Junikas në objektin e Valavicës.

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik duke parë mos-gatishmëri në shlyerjen e borxheve nga Bizneset që operojnë në Junik, gjatë kësaj periudhe pandemike nuk e ka parë të arsyeshme që taksat për ushtrim të veprimtarisë t'i inkasoj përmes përmbaruesit privat.

- Sfidë kryesore për Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik ka qenë buxheti i limituar që ndikon drejtpërdrejt në arritjen e objektivave dhe qëllimeve që kemi si Drejtori. Edhe pse drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka patur vështirsi buxhetore, ka arritur të zhvillojë aktivitetet e parapara duke ju falënderuar donatorëve të ndryshëm

- Te gjitha këto aktivitete janë kryer ne konsultim dhe ne bashkëpunim me Kryetarin si dhe ne koordinim edhe me drejtoritë tjera.

URBANIZËM

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis për periudhën gjashtë mujore të vitit 2021 ka kryer punë në përputhje me planin e punës së kësaj drejtorie për gjysëm vitin 2021, statutin e komunës së Juniku dhe ligjeve të cilat e rregullojnë veprimtarinë e kësaj drejtorie. Për gjysëm gjysëm vitin 2021,

Sipas statutit të komunës operon me 5 punëtor, të ndarë në dy sektorë funksional :

- **Spektori për Urbanizëm,**
- **Spektori për Kadastër .**
- **Spektori për urbanizëm:**

Në sektarin për urbanizëm janë të angazhuar gjithsejtë 3 (tre) punëtorë. Puna e tyre konsiston në respektimin e planeve të miratuara qofshin ato plane hapësinore ose plane urbane brenda territorit të komunës së Junikut, si dhe në përcjelljen e zbatimit të projekteve nga fusha e ndërtimit ku investues është komuna ose investimet janë të përbashkëta në mes të komunës dhe donator të ndryshëm.

Fushës së planifikimit Hapsinor i është dhënë rëndësia e merituar, prandaj edhe ka hartu një numër të konsiderueshëm planesh.

Komuna e Junikut zotëron këto plane:

- **Plani Zhvillimor Komunal,**
- **Vlerësimin e Implementimit të Planit Zhvillimor Komunal,**
- **Plani Zhvillimor Urban,**
- **Plani Lokal për Veprim në Mjedis,**
- **Plani Rregullues Urban “Qendra”,**
- **Plani Rregullues Urban njësia “Gacafer dhe Pepsh”, dhe**
- **Plani Rregullues Urban njësia “Krasniq dhe Bajrakatar”.**
- **Jemi në proces të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale sipas Ligjit të ri.**

Punëtorët e këtij sektori po mundohen me çdo kusht që të respektohen planet e miratuara gjatë ndërtimeve që po bëhen në zona të caktuara, mirëpo edhe përkundër përpjekjeve të mëdha rezultatet nuk janë të kënaqshme.

Puna e vazhdueshme e kësaj drejtorie gjatë këtij viti ka qenë e orientuar në:

Mbikqyrje në realizimin e projekteve komunale si dhe

Punimi i Projekteve, *paramasës dhe parallogarisë* si dhe përshkrime teknike për Projekte të ndryshme për nevoja të komunës.

Ekspertët e kësaj drejtorie me sukses kanë përcjellë dhe përfunduar një varg projektsh investive të cilat janë investuar nga buxheti i komunës apo i ministrive si dhe donatorët e tjerë.

- **Spektori për kadastër:**

Në sektorin për kadastrë kanë qenë të angazhuar gjithsejtë 2 (dy) punëtorë. Puna e tyre ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve kadastrale palëve të interesuara. Përveç ofrimit të shërbimeve kadastrale për palët, personeli i këtij sektori është ngushtë i lidhur edhe në ndihmën që i ofrojnë sektorit për urbanizëm në fushën e gjeodezisë po ashtu edhe në përcjelljen e projekteve investive për shkak të mungesës së punëtorëve të mjaftueshëm në sektorin e urbanizmit. Humbje e madhe për këtë drejtori ka qenë vdekja e papritur e zyrtarit të lartë për kadastrë z. Xhemë Shehu. Me këtë rast shprehim respekt të veçantë për veprën dhe jetën e tij.

Ky sektor në kuadër të drejtorisë ofron këto shërbime:

Në formë tabelore po japim të dhënat statistikore të këtij sektori për gjysëm vitin 2021:

1. Bartja e posedimit - Ndarje fizike
2. Bartja e posedimit – Blerje
3. Bartja e posedimit – Dhurim
4. Bartja e posedimit – Trashëgimi
5. Bartja e pronësisë – Ndarje fizike
6. Bartja e pronësisë-Këmbimi
7. Bashkim parcelave
8. Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit
9. Lëndë sipas detyrës zyrtare
10. Modifikimi i attributeve të parcelës
11. Modifikimi i të dhënave për person
12. Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale
13. Ndarja e parcelave
24. Regjistrimi i hipotekës
25. Nxerrja e historikut të pronësisë
26. Shërbimi i të dhënave – nxjerrja e çertifikatës
27. Shërbimi i të dhënave – Vërtetim që nuk posedon tokë

Përveç kërkesave në mesin e lëndëve dalëse një numër i caktuar i këtyre lëndëve është edhe njoftime me anën e të cilave është dashtë që palët apo subjektet të njoftohen lidhur me planet e komunës ose që të njëjtat të njoftohen lidhur me procedurat ligjore për realizimin e të drejtës së tyre për parashtrim kërkesë.

ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoaria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport gjatë periudhës Janar – Qershor 2021, ka realizuar aktivitetet e saj sipas planifikimit paraprak.

Ri tenderimi i transportit të nxënësve me autobus nga Lagja “Agim Ramadani”, deri në lokacionet e Gjinnazit “Kuvendi i Junikut”, si dhe për nxënësit e rekes së Keqe edhe për 3 vitet në vazhdim, Me rastin e përvjetorit të Heronjve të Kombit “ Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu”, janë organizuar aktivitete të shumta Sportive, Kulturore dhe Rinore.

Me rastin e përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës janë Organizuar aktivitete të shumta nga Komuna e Junikut në bashkëpunim me shkollat,

Kanë vazhduar punimet në ndërtimin e objektit të ri në shkollën fillore dhe e mesme e ulët “Edmond Hoxha” projekti po financohet nga Ministria e Arsimit shkencës dhe Teknologjisë,

Me rastin e 7 dhe 8 Marsit janë organizuar garat e recitatorëve, dhe garat në ping pong, si dhe një program kulturo-argëtues nga nxënësit e shkollës fillore dhe M.U.”Edmond Hoxha” dhe të gjinnazit të përkrahur financiarisht nga Komuna e Junikut,

Është bërë angazhim gjatë dezinfektimit të objekteve arsimore në Komunën e Junikut, si dhe furnizimi me lende djegëse për ngrohje (dru) për shkollat e komunës së Junikut (130 metra në shkollën fillore dhe 40 m në gjinnaz, si dhe sharritja).

Lidhur me pajisjen me tekste mesimore janë dorëzuar kërkesat me kohë për furnizim me tekste shkollore për nxënësit të shkollës fillore nga klasa parafillor e gjerë në klasën e nënte, kërkesa është aprovuar nga MASHT-i, si dhe kërkesat për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë të shkollës fillore dhe në shkollën e mesme të lartë klasat e 10-ta, sipas afateve ligjor.

Edhe përkundër vështirësive procesi mësimor është realizuar dhe ka përfunduar konfom planifikimit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, dhe në vijim do të pasqyrohen informacionet lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2020-2021:

-Testi i arritshmerisë do të mbahet me (është anulë me vendim të MASHT-it)

Testi i provimit të maturës shtetërore do të mbahet

Në vazhden e përgaditjeve për fillimin e vitit të ri shkollor është bërë përgaditja e projektit për material higjienik dhe me materiale administrativ për dy shkollat e Komunës së Junikut.

SHËNDETËSI

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mireqenie Sociale ka realizuar aktivitetin e saj bazuar në objektivat dhe politikat shëndetësore për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, gjithnjë duke bashkëpunuar me menaxhmentin e QKMF-së me qëllim të kuptuarit sa më afër gjendjes së përgjithshme në këtë institucion.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) ka ofruar të gjitha shërbimet e Shëndetit Parësor me orar ditor pune 7,00 deri në ora 21,00. Ndërkaq në mungesë të stafit është i pa mundshëm organizimi 24 orësh i punës në këtë qendër. Në këtë gjashtëmujor ka realizuar- 16,091, shërbime/ vizita mjekësore, vizita stomatologjike, intervenime, analiza laboratorike, vaksinime, dhe shërbimi i barnatores/.

QKMF ka këtë Strukturë Organizative:

- I. Sektori i i Shëndetit Publik
- II. Sektori i Mjekësisë Familjare
 - Njësia e SISH-it
 - Njësia e Imunizimit dheVaksinimit
 - Njësia e Stomatologjisë
 - Laboratori.
 - Barnatorja Qendrore (Barnatorja është njësi organizative e QKMF-së)

Sfidat në Kujdesin Primar Shëndetësor

Obligime të bartura nga viti vijues si pasoj e buxhetit të vogël, për mallra dhe shërbime , në pagesat e kujdestarive, punës jashtë orarit, punës gjatë festave,të cilat mbetën të pranishme edhe përkundër orvatjeve të parreshtura për t'i zgjidhur.

Furnizimi me barna nga lista esenciale

Autoritetet e Kosovës për Regullativën e Barërave (AKRB) ka aprovuar listën e barërave esenciale, të nevojshme për të plotësuar nevojat shëndetësore të popullatës së Kosovës. Për shpërndarjen e këtyre barërave kujdeset Korporata Farmaceutike e Kosovës (KFK) varësisht prej nevojave të Kujdesit Primar

Shëndetësor. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, produktet farmaceutike nga lista esenciale, janë planifikuar në bazë të numrit të pacientëve të regjistruar në QKMF. Sa i përket furnizimit të QKMF me barëra nga Korporata Farmaceutike e Kosovës/Ministria e Shëndetësisë për periudhën vjetore për vitin 2020 ka qenë jo i kënaqshëm për shkak të vështirësive që janë paraqitur nga departamenti i farmaceutik pranë Ministrisë së Shëndetësisë,edhe përkundër porosive që janë bërë në mënyrë të rregullt.

Pacient që marrin shërbime të rregullta mujore janë (42)(*të sëmurë nga diabeti ,që marrin insulin*).

Vazhdimisht këtë vit shërbimi primar ka qenë i mbuluar me produktet e nevojshme të listës esenciale. Furnizimi me **Insulinë** për pacientët e Komunës sonë,ka qenë i kënaqshëm deri në

muajn e fundit ku po vërehën vështirësi në furnizim ,nga departamenti farmaceutik i Ministrisë së Shëndetësisë.

SEKTORI I SHËNDETIT PUBLIK: Shëndeti është Mirëqenia e plotë Mentale, Fizike dhe Sociale por jo vetëm mungesë e ndonjë Sëmundje.

Objekti i Këtij Sektori në planin veprues ka për qëllim promovimin, edukimin shëndetësor të popullatës në Komunën e Junikut me qëllim të ngritjes së shkallës më të lartë të vetëdijes të qytetarëve, se si të mbrohen nga sëmundjet ngjitëse dhe jongjitëse, në të cilat eventualisht mund të përballohen qytetarët e Komunës së Junikut.

SHËRBIMI I SHËNDETIT PUBLIK

Me Institutin Kombëtar për Shëndetësi publike kemi marrëveshje për mbikëqyrjen e ujerave dhe ky institucion raporton sipas nevojës për gjendjen e ujerave sanitare bakteriologjike kimike të ujit të pijes në Komunën e Junikut.Raportimi është bërë në mënyrë të rregullt dhe me kohë.

Vaksinimi

Në komunën e Juniku **vaksinimi** kryhet në mënyrë kontinuele (dhe në formë kampanje mobile). Vaksinimi është kryer me sukses, si dhe plani për, sensibilizimi i popullatës për vaksinim.

Programi i Zgjeruar i Imunizimeve po bëhet bazuar në Planin Strategjik të përgatitur nga Komiteti Nacional i Imunizimeve për Kosovën.Plani i imunizimit është punuar në bazë të dokumentacionit ekzistues (kartotekës). (dhe vete lajmërimi për vaksinonim),furnizimi me vaksina nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Prishtinë është realizuar në baza mujore. Për të arritur suksesin e duhur të vaksinimit ka pasur angazhim maksimal.

Ndihmë financiare

Edhe këtë vit , shëndetësia është ballafaquar edhe më vështirësi të mëdha siç janë: buxheti i pamjaftueshëm, vështirësi në pagesat e kujdestarive, punës jashtë orarit, punës gjatë festave .

Shumë pacient sidomos ata në asistencë sociale nuk kanë mundësi që vet ti blejnë barërat dhe janë të detyruar që të kërkojnë ndihmë në mjete financiare nga Komuna dhe Ministria e Shëndetësisë.

Vështirësitë:

Vështirësi serioze për organizimin e punës në QKMF, paraqet stafi jo i mjaftueshëm dhe paisjeve në:

- a. Në kujdesin parësor shëndetësor ekzistues,
- b. Të specialistëve konsulent

- c. Në departamentin e Administratës
- d. Në stafin teknik
- e. Në sektorin Diagnostikues
- f. Në shërbimin teknik

Ne kujdesin parësor shëndetësor ekzistues,

- Stafin mjekësor
- Punëtorë shëndetësor- staf i mesëm

b. Të specialistëve konsulent

- Internisti (kardiologji)
- Pediatri
- Gjinekologji
- Psikiatri
- Radiologji dhe
- Specialist ekzistues të sektorëve tjerë
- Infermierët, mamitë, fizioterapeut dhe teknik mjekësor.

c. Ne departamenti i Administratës

- Zyrtari i personelit
- Zyrtari juridik
- Arkëtar

d. Në stafin teknik

- vozitës l.
- Sigurim objekti

f. Në Shërbimin teknik

- Një autoambulanca për nevoja emergjente.

Shërbimet Sociale dhe Shërbimi i Kujdestarisë

Gjate kësaj periudhe, shërbimi Social dhe shërbimi i Kujdestarisë i ka zhvilluar këto Aktivitete.

- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Delikuencë e të miturve - Besimi i fëmijëve - Procedura të Pajtimit për çiftet bashkëshortore me probleme në bashkëshortësi - Shkurorëzime - Kontaktim prind- fëmijë - Fëmijë me aftësi të kufizuar- kërkesa për ndihme Sociale - Caktim i kujdestarisë | <ul style="list-style-type: none"> - Dhunë familjare - Martesa para moshës madhore - Bashkim familjar - Fëmijë nën kujdestari - Strehim familjar - Strehim familjar tek te afërmit - Strehim në institut special ISSH (për persona me aftësi të kufizuar) - Vërtetim për humbjen e shtetësisë - Këshilla për persona ne nevojë |
|---|---|

SHËRBIMI I SKEMËS SË NDIHMËS SOCIALE

Gjatë këtij gjashtemujorit, shërbimi i skemës së ndihmës sociale ka zhvilluar, këto aktivitete sipas detyrave të punës:

- Menaxhimin e Skemës së ndihmës sociale.
- Pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave të reja për ndihmë sociale.
- Verifikimin në terren të kërkesave të reja për ndihmë sociale.
- Pranimi i riaplikimeve për ndihmë sociale dhe shqyrtimin e tyre.
- Verifikimi dhe riverifikimi në teren i kërkesave të reja dhe riaplikimeve për ndihmë sociale.
- Pranimi i Raporteve mjekësore, procedimi i tyre dhe dërgimi i tyre në Komision mjekësor për ekzaminim.
- Pranimi dhe shqyrtimi i Ankesave dhe dërgimi i tyre në shkallë më të larta të ankesës.
- Operimi me Bazën e të dhënave të SNS-s.
- Raportimi.

Gjatë këtij gjysëm-viti kemi punuar shumë dhe duke pasur parasysh gjendjen e jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia COVID 19, kemi pasur detyra dhe punë shtesë jashtë detyrave të caktuara si psh. Pranimin dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare si dhe pranimin, procedimin dhe futjen në bazë të dhënave të Aplikacioneve për pakon emergjente M145. Gjatë këtij gjysëm viti shpesh herë kemi punuar me orarë të zgjatur dhe kemi punuar edhe ditëve të vikendit dhe mendoj se kemi qenë shumë efikas dhe të sukseshëm me arsye se të gjithë Qytetarëve (Klientëve) që kanë kërkuar ndihmën dhe shërbimet tona ua kemi ofruar në kohë dhe me mirësjellje.

Të gjitha punët dhe aktivitetet e SNS (Skemës së Ndhmës Sociale) janë të paraqitura më poshtë të cilat i kemi kryer duke u bazuar në Ligjin për Skemën e Ndhmës Sociale 2003 /15 dhe në Ligjin për ndryshimin e ligjit të SNS 2003/15, Ligjin 04/L- 096.

Janë shqyrtuar kërkesa për Riaktivizim në ndihmës sociale, për periudhën Janar-Qershor për vitin 2021, Ankesa dhe kërkesa për rishqyrtim të aprovuara dhe të refuzuara kundrejt ndërprerjeve të ndihmës sociale, dhe janë lëshuar vërtetimet mbi këtë bazë.

Aplikacione me raporte mjekësore, për persona me paafësi fizike, të ekzaminuara nga Komisioni mjekësor i angazhuar nga MPMS/DPSF në Prishtinë, për ndihmë sociale, në gjashtëmuorin Janar-Qershor për vitin 2021

Gjatë Periudhës Mars - Qershor 2021 kemi pranuar ndihma humanitare dhe kemi bërë pranimin dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare, sipas urdhrit të Shtabit të Emergjencës në Komunën e Junikut. Këto ndihma kanë ardhur nga organizata dhe Shoqata të ndryshme dedikuara familjeve në nevojë si pasojë e shkaktuar nga pandemia e COVID 19. Ndihamat e pranuar dhe të shpërndara deri me tani kanë qenë pako ushqimore dhe pako Higjienike. Më poshtë poshtë ju paraqesim të dhënat e Donatorëve dhe të Përfituesve të këtyre ndihmave në tabelat në vijim.

Familjet përfituese të Skemës së ndihmës sociale përpos ndihmës në para të gatshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) këto familje i ndihmon duke jua paguar Energjinë Elektrike në lartësinë deri në 20 euro për muaj.

Familjet përfituese me të gjithë anëtarët e tyre përfitojnë Shërbime Mjekësore falas në të gjitha Qendrat Mjekësore Publike.

Të gjithë anëtarët e këtyre familjeve janë përfitues të shërbimeve administrative falas në të gjithë administratën publike (Shtetërore) të Republikës së Kosovës.

Të gjithë anëtarët e këtyre familjeve që vijnë studime universitare dhe pas universitare në Univesitetet publike të Republikës së Kosovës janë të liruar nga të gjitha pagesat.

PROKURIMI PUBLIK

Zyra e Prokurimit në Komunën e Junikut organizon dhe zhvillon procedura për të gjitha aktivitetet e prokurimit që vijnë si kërkesa nga departamentet kërkuuese (Njësia e Kërkesës) bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92 (këtu e tutje LPP), bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për procedurat e prokurimit si dhe legjislacionin sekondar në fuqi që ndihmon në zhvillimin e procedurave dhe implementimin e tyre.

Zyra e Prokurimit udhëheqë dhe menaxhon me të gjitha çështjet që lidhen me prokurimin në Komunën e Junikut. Përgadit planin preliminar dhe përfundimtar të prokurimit dhe e dërgon në AQP brenda afatit kohor të paraparë me ligj, përgadit raportin vjetor për kontratat e nënshkruara gjatë atij viti fiskal dhe e dërgon në KRPP. Zyra e Prokurimit organizon dhe menaxhon tenderët varësisht nga vlera e parashikuar, organizon dhe menaxhon kuotimet e çmimeve, vlerat minimale si dhe të gjitha procedurat tjera.

Për shkak të transparencës publikon me kohë Njoftimet e Prokurimeve në sistemin e- prokurimi dhe në web faqe të Komunës.

Përmes sistemit elektronik, Zyra e Prokurimit krijon user dhe çelësa privat për secilin anëtar të hapjes dhe të vlerësimit duke ofruar transparencë të plotë në secilin aktivitet të prokurimit. Kryen

edhe punët tjera që dalin për zhvillimin dhe realizimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit që Autoriteti Kontraktues parasheh t'i prokurororj gjatë vitit fiskal.

Gjatë periudhës kohore 01.01.2021- 30.06.2021, Zyra e Prokurimit ka nënshkruar gjithsej 7 kontrata për projekte të ndryshme të cilat i ka zhvilluar përmes procedurave të prokurimit.

Të Hyra Vetanake (1) ose	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
Numri rendor i prokurimit	636-21- 1925-2- 2-1	2	2	2	1	85	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale për personat në nevojë në Komonën e Junikut	13.4.2021.	14.4.2021.	8.6.2021.	31.5.2021.			81,700.00	81,600.00
Lloji i prokurimit		2	2	1	1	80	Ofrimi i shërbimeve administrative profesionale, edukative, kulturorë dhe psiko- sociale në Komonën e Junikut	13.4.2021.	14.4.2021.	8.6.2021.	31.5.2021.			147,500.00	#####
Vlera e prokurimit		5	2	2	1	45	Ndërtimi i ujësjesit të lagjes Agim Ramadani - Junik	17.3.2021.	5.4.2021.	15.7.2021.	13.7.2021.			100,000.00	86,036.20
Vlera e prokurimit		5	2	2	1	45	Memoriali i Dëshmorëve të UÇK- së- Junik	28.4.2021.	21.5.2021.	10.9.2021.	9.7.2021.			50,000.00	48,360.00
Vlera e prokurimit		5	2	2	1	65	Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik	27.5.2021.	9.6.2021.	16.7.2021.	13.7.2021.			30,000.00	24,837.60
Klasifikimi (2 shifrat e para të															
Titulli i aktivitetit të prokurimit															
Data e inicimit të aktivitetit të prokurimit															
Data e publikimit të njoftimit për kontratë															
Data e publikimit të njoftimit për dhënie të															
Data e nënshkrimit të kontratës (në rast anulimi															
Afatet për implementimin															
Data e përmbylljes së															
Vlera e parashikuar e kontratës															
Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.															

636-21-3176-1-3-6	1	3	6	02	Furnizim me dru për shkolla të Komunës së Junikut	22.4.2021.	27.5.2021.	16.7.2021.	9.7.2021.		9,000.00	8,498.50
636-21-3597-5-2-1	5	2	1	36	Ndërtimi i parkut të lojërave për fëmijë	24.5.2021.	11.6.2021.	2.9.2021.	9.8.2021.		15,264.00	14,314.00

AUDITORI I BRENDSTEM

Njësia e Auditimit të Brendshëm vazhdon me misionin e saj themelor, si aktivitet i pavarur këshillëdhënës, dhe i ofrimit të sigurisë objektive, i përcaktuar (projektuar) që të shtojë vlerat dhe të përmirësojë funksionimin e organizatës. Ai ndihmon organizatën në përmbushjen e objektivave të saja duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Njësia Auditimit të Brendshëm në komunën e Junikut funksionon në bazë të Ligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike 06/L-021, Statuti për auditimin e brendshëm, doracakeve dhe standardeve për auditimi të brendshëm. Ne përbërjen e vetë njësia përmban një auditor, njëkohësisht auditori ka edhe funksionin e Drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Njësia e auditim të brendshëm në komunën e Junikut nuk ka buxheti të ndarë në kategori të veçantë, por jemi në kuadër të zyrës së kryetarit.

Përmes raporteve të auditimit të brendshëm, ne kemi dhënë rekomandime konstruktive dhe të qarta për ndryshim dhe përmirësim atëherë kur kemi gjetur dobësitë, konsiderojmë se kjo ka dhënë rezultate të mira. Ne gjithashtu kemi përcjell nga afër mënyrën se si menaxhohen dhe adresohen rekomandimet tona, dhe vazhdojmë të punojmë në partneritet të ngushtë me menaxhmentet. Ne synojmë të veprojmë si drejtuesi kryesor për ndryshim në Menaxhimin e Financave Publike.

Fushat dhe aktivitetet e audituara

Sic jeni edhe ju të njoftuar për shkak të sëmundjes me koronavirus 2020 (COVID-19) që ishte shpërndara dhe në Kosovë ishim të obliguar që një pjesë dërmuese e stafit të pushojnë nga puna ashtu dhe unë gjatë periudhës muajve: Mars, Prill, Maj dhe Qershor duke zhvilluar disa aktivitetet të mundshme nga shtëpia. Pas kësaj situatë dhe kohës së humbur dhe kërkesës së NJQHAB, ishte e nevojshëm ri-shikimi i planit vjetor, ku ne konsultim të ngushtë me ekspertin Naim Behluli kemi bërë ndryshimet e nevojshme, ku kemi konstatuar që është e nevojshëm anulimi i planifikuar për katër mujorshin e fundit “Subvencionet dhe Transferet”, ku pastaj është aprovuar nga komiteti i auditimit dhe Zyrtari Kryesor Administrativ. Andaj ky auditim i planifikuar për periudhën; Nëntor dhe Dhjetor **D – E fshihet/anuluar** nga Plani Vjetor 2021.

Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore me shumë duke i zhvilluar aktivitetet nga shtëpia. Me ndihmë të ekspertit të USAID-it Naim Behluli kishim arritur ta ri – shikojmë dhe modifikojmë Statutin e Auditimit të Brendshëm të komunës së Junikut, me qenë se ishte edhe rekomandim i dhënë në Raportin për monitorimin e aktiviteteve të NJAB në komunën e Junikut nga NJQHAB.

Edhe pse ishin të planifikuar sipas planit vjetor dhe strategjik dy aktivitete të realizohen në periudhën gjashtëmujorë por për shkak të situatës së krijuar me koronavirus 2020 (COVID-19),

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB), ka realizuar një aktivitet të auditimit. Në këtë aktivitet të realizuar dhe pse jo sipas kohës së parapara kemi nxjerrë gjithsejtë 9 të gjetura dhe 6 Rekomandime në mënyrë sintetike ose përmbledhëse. Ne vijim kemi paraqitur detaje nga aktiviteti të realizuara të auditimit:

- Është finalizuar raporti i auditimit të rregullsisë dhe pajtueshmërisë për inventarizimin dhe regjistrimin e pasurisë jo financiare të titullar me emrin **“Auditim për menaxhimin e pasurive jo financiare”** - (Ref. DSHS 2001/ 2021/data/ 17.02.2021 – 15.07.2021)

Vlerësimi përfshin aktivitetin e përgjithshëm të procesit të regjistrimit të pasurive të komunës duke përfshirë, formimin e komisioneve, fillimin e procesit të inventarizimit, verifikimit, krahasimit dhe identifikimit të pasurive si ato me vlerë të bartur, po ashtu edhe ato të dëmtuara dhe jashtë funksionit. Vlerësimin e tyre nga ana e komisionit të vlerësimit, dhe në fund regjistrimi i tyre nga Zyrtari i Pasurisë.

Ky angazhim është zhvilluar në kuadër të Planit Vjetor 2021 për aktivitetet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Komune të Junikut.

Në bazë të kërkesave ligjore që dalin nga Ligji për kontrollin e brendshëm të financave publike 06/L-021 dhe në përputhje me Statutin e auditimit kemi përgatitur dhe dërguar në NjQHAB raportin gjashtëmuor për të gjitha aktivitetet e realizuar nga Njësia e auditimit të brendshëm të komunës së Junikut.

Kemi mbajtur trajnime përmes Skype Business të organizuar nga USAID për Auditimin e performancës me datë 28 dhe 29 Maj 2021.

Këto janë disa nga aktivitetet e identifikuar nga NjAB-i që kërkojnë angazhim të përbashkët dhe serioz. Të cilat do të ndikonin direkt në rritjen e performancës së përgjithshme në komunën e Junikut.

Zyra e Personelit

Hyrje

Zyra e personelit edhe gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2021 ka vazhduar me perkushtim maksimal në sigurimin e zbatimit të procedurave ligjore lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në Komunën e Junikut.

Të gjitha aktivitetet janë zhvilluar konform dispozitave të përcaktuara sipas Ligjit për Zyrat e Publik (LIGJI NR. 06/L – 114) dhe akteve nënligjore të ndërlidhura me këtë ligj:

2. RREGULLORE_(MPB)_NR._02_2020_PËR_PLANIFIKIMIN_E_PERSONELIT
3. RREGULLORE_(MPB)_NR._012020_PËR_PËRMBAJTJEN_ADMINISTRIMIN_DHE_PËRDORIMIN_E_DOSJES_SË_PERSONELIT_DHE_SISTEMIT_INFORMATIV_TË_MENAXHIMIT_TË_BURIMEVE_NJEREZORE
4. RREGULLORE_(QRK)_NR._11_2020_PËR_DISIPLINËN_DHE_ANKESAT_E_ZYRTARËVE_PUBLIKË
5. RREGULLORE_(QRK)_NR._13_2020_PËR_LIRIMIN_DHE_PENSIONIMIN_E_PARAKOHSHËM_NGA_SHËRBIMI_CIVIL-5
6. RREGULLORE_(QRK)_NR._16_2020_PËR_PRANIMIN_DHE_KARRIERËN_NË_SHËRBIMIN_CIVIL_TË_REPUBLIKËS_SË_KOSOVËS
7. RREGULLORE_(QRK)_NR.10_2020_PËR_DEKLARIMIN_E_STATUSIT_TË_ZYRTARËVE_PUBLIKË
8. RREGULLORE_(QRK)_NR.12_2020_PËR_ORARIN_E_PUNËS_DHE_PUSHIMET_E_ZYRTARËVE_PUBLIKË-6
9. RREGULLORE_(QRK)_NR.14_2020_PËR_TRANSFERIMIN_E_NËPUNËSVE_CIVILË
10. RREGULLORE_NR.15_2020_PËR_PRANIMIN_VLERËSIMIN_DHE_DISIPLINËN_E_NËPUNËSVE_TË_LARTË_DREJTUES

Në udhëheqjen e punës së gjithmbarshme të njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit janë identifikuar dhe caktuar objektivat kryesore, dhe në bazë të kësaj është hartuar edhe plani i punës për përmbushjen e këtyre objektivave.

Për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme janë rekomanduar ndryshime/përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë duke siguruar zbatimin e legjislacionit lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.

Gjithashtu nën përgjegjësinë e sigurimit të mbarëvajtjes së procedurave të rekrutimit të nëpunësve civil, dhe nëpunësve publik, janë përgatitë konkurset, akt emërimet, kontratat për marrëdhënien e punës duke proceduar më tutje pagat si dhe krijimi dhe mirëmbajtja e dosjeve të personelit.

Në bashkëpunim të vazhdueshëm janë mbështetur udhëheqësit e njësive organizative të institucionit lidhur me përshkrimet adekuate të vendeve të punës, ofrimi i ndihmes kur është kërkuar në vlerësimin e punës së personelit, zhvillimin e karrierës dhe ngritjes profesionale përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.

Në gadishmëri të mbështetjes së punës të Komisionit për ankesa dhe parashtrësia dhe Komisionit disiplinor duke marr parasysh punën e shkelqyeshme të zyrtarëve konform procedurave të përcaktuara me aktet ligjore dhe nënligjore, fatmirësisht nuk kemi pas raste për aktivizimin e këtyre komisioneve.

Në vazhden e aktiviteteve të Zyrës së Personelit gjatë gjashtemujorit të parë 2021, në vijim do të listohen disa nga aktivitetet e kryera gjatë vitit kalendarik:

1. Plan i punës për vitin 2021 të hartuar sipas procedurave elektronike në SIMBNJ,
2. Hartimi i planit të trajnimeve,
3. Menaxhimi i listave të pagave,
4. Rregullimi, sistemimi dhe ruajtja e dokumentacionit të shërbyesve civil,
5. Hartimi i akteve të emërimit,
6. Përgatitjen e aktvendimeve për pushime vjetore,
7. Hartimi i vërtetimeve nga marrëdhënia e punës,
8. Hartimi i bazës së të dhënave për të gjithë zyrtarët,
9. Inicimi i procedurave të rekrutimit,
10. Hartimi i raporteve periodike për DASHC-në,
11. Evidentimi i respektimit të orarit të punës,
12. Raportimi i rregullt në Agjensionin Antikorrupcion të Kosovës,
13. Informimi i zyrtarëve të lartë publik për deklarimin e rregullt të pasurisë,
14. Ofrimi i informacioneve dhe ndihmës rreth vlerësimeve të rezultateve të punës.

Vlenë të theksohet se gjatë vitit 2021 falë bashkëpunimit të mirëfillt me Departamentin Menaxhimit të Zyrtarëve Publik, kemi arritur të bëjmë realizimin e disa procedurave të rekrutimit nga planifikimi për vitin 2021r.

Sa i përket raportimi në Agjensionin Antikorrupcion të Kosovës me kërkesë të këtij institucioni janë ofruar deklarime të rregullta lidhur me ndryshimin e statusit të zyrtarëve të lartë publik.

Gjatë vitit 2021, Zyra e Personelit ka zhvilluar procedurat e rekrutimit për Administratën Komunale, QKMF-në dhe DKA-në.

Gjithashtu Zyra e personelit ka hartuar edhe akte juridike për Zyrën e Kryetarit.

Shërbimi i Kuvendit

Ky shërbim gjatë kësaj periudhe ka kryer shërbime juridike për Kuvendin Komunal konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi. Në periudhën raportuese janë kryer shërbimet si në vijim:

1. Raportimi i rregullt në periudha periodike në MAPL,
2. Mbajtja e të dhënave për anëtarët e Kuvendit Komunal,
3. Hartimi i vërtetimeve,
4. Informimi i MAPL-së dhe anëtareve të Kuvendit për aktivitetet e Kuvendit,
5. Dërgimi i të gjitha aktëve të aprovuara nga Kuvendi brenda afatit ligjor për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë në Departamentin ligjor.

Shërbimi i Kuvendit

Ky shërbim gjatë kësaj periudhe ka kryer shërbime juridike për Kuvendin Komunal konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi. Në periudhën raportuese janë kryer shërbimet si në vijim:

6. Raportimi i rregullt në periudha periodike në MPL,
7. Mbajtja e të dhënave për anëtarët e Kuvendit Komunal,
8. Hartimi i vërtetimeve,
9. Informimi i MAPL-së dhe anëtareve të Kuvendit për aktivitetet e Kuvendit,
10. Dërgimi i të gjitha aktëve të aprovuara nga Kuvendi brenda afatit ligjor për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë në Departamentin ligjor.

SHËRBIMEVE PUBLIKE, ISNPEKSION, MBROJTJE DHE SHPËTIM

Qellimi I Sektorit të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspeksion për vitin 2021 ishte që të ngrisin cilësinë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në fushat të cilat i kemi të përcaktuara, andaj ne si Sektor kemi synuar këto objektiva:

Monitorimi i trajtimit të ujërave të zeza;

Mirëmbajtja e hapësirave publike (trotareve, shesheve dhe parqeve);

Rregullimi i transportit publik të nxenësve në të gjitha Lagjet;

Mirëmbajtja e ndriçimit publik;

Monitorimi dhe menaxhimi i mbeturinave;

Mirëmbajtja e ambientit dhe moslejimi i deponive Ilegale

Mirëmbajtja rrugëve gjatë sezonit dimëror dhe veror;

Hapja e rrugëve fushore;

Inspektimet në lëmin e ndërtimit, tregtisë, sanitarisë, fitosanitar dhe në çështjet komunale dhe të komunikacionit.

Sektori për Shërbime Publike dhe Inspeksion për vitin 2021 ka pasur objektiv që, të realizojë shërbimet publike për komunitetin dhe t'i përmirësojë ato vazhdimisht duke programuar, planifikuar, monitoruar dhe realizuar këto objektiva në interes të komunitetit qytetar, të ndërtojë strategjitë për programimin, planifikimin dhe implementimin e investimeve në projektet publike.

Drejtoria për SHPIM&SH në K. Junik i ka perfillur te gjitha Urdheresat e MEPTINIS per mbarevajtjen e veprimtarive ekonomike gjate emergjencës së shendetit publik si dhe zbatimi i Urdhëresave të IKSHPK per parandalim te Pandemisë Corona 19.

Të planifikuara	1	2	Punëve		Realizimi
			3	4	
01	Raport për Shërbime Publike Inspeksion Mbrojtje dhe Shpëtim për periudhën 1 Janar – 4 Qershor 2021 Plani i Punës së Drejtorisë për SHPIM&SH për Vitin 2021 Hartimi i Planit Lokal për Trafik dhe Plani Lokal për Mbeturina	Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, Ligjet dhe Rregulloret Komunale për Inspeksion.	Drejtori i DSHPI&SH dhe Shefi i Sektorit për SHP dhe I	Bashkëpunim me Drejtorin e DSHPI&SH dhe SH si dhe me Inspektoret, Udhëheqësin e NJPZSH.	Janë hartuar raportet periodike (tre, gjashtë, nëntë mujore dhe vjetore) për Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Inspeksion. Si dhe është bërë përgatitja e planit vjetor për vitin 2021 për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Inspeksion.
02	Mbikëqyrje punët operative të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Inspeksion.	Planet e punës	Shefi i Sektorit për SHP dhe I	Inspektorët, NJPZSH-në dhe Drejtorit tjerë.	Është bërë mbikëqyrja e punës së Inspektorëve konform Planeve të punës së tyre për periudhën 1 Janar- 4 Qershor të vitit 2021, si dhe realizimi i detyrave të punës që dalin nga planet e punës.
03	Mbajtja e bazës së të dhënave të pagesave nga Drejtoria për SHPIM&SH si dhe miratimi i lendeve në Intranet	Planet e punës, rregulloret komunale	Shefi i Sektorit për SHP dhe I	Drejtori i DSHPI&SH, Inspektoret komunale	Mirëmbajtja e bazës së të dhënave për Drejtorinë përkatëse si dhe është bërë miratimi i të gjitha lëndëve përmes Intranetit. Janë shqyrtuar të gjitha lëndet deri më 04.06.2021 të bëra nga qytetarët apo institucionet tjera në Drejtori.

04	Përgatitja e pëlqimeve, vendimeve dhe aktvendimeve të Drejtorisë së SHPIM dhe SH. Hartimi i rregullores për Shërbime Publike	Ligjet dhe Rregulloret Komunale për SHP&Ins.	Shefi i Sektorit për SHP dhe I	Drejtori i DSHPIIM&SH ,Inspektorët komunal	Gjatë periudhës deri më 04.06.2021 vitit 2021 Është mbajtur Baza e të dhënave të Drejtorisë për SHPIIM&SH. Janë bërë përgatitja dhe lëshimi i 3 Aktvendimeve për plotësim të kushteve hixh-tek-sanitare , 7 Pëlqimeve (prerje asfalti per kyqje ne rrjet te ujesjell.dhe kanalizimit), 2 Njoftime, 1 Autorizime, 11 Kerkesa, etj.
05	Percjellja dhe menaxhimi i realizimit të projekteve në drejtori, jep vërejtje dhe udhëzime kompanive përgjegjëse për kryerjen me kohë të shërbimeve ndaj qytetarëve	Ligji i Prokurimit Publik të Kosovës	Drejtori i DSHPIIM&SH, Shefi i Sektorit për SHP dhe I	Zyrën e Prokurimit,Drejtorit e komunës, NJPZSH-në, Inspektorët.	Është bërë përcjellja dhe menaxhimi i 3(tri) projekte në drejtori dhe janë evidentuar te gjitha te dhënat e tyre në data bazën e drejtorisë.
06	Benë vlerësimin e kryerjes së shërbimeve nga ana e kompanive ,njofton Drejtorin e Drejtorisë me të arriturat, problemet dhe nevojat që kanë. Inspektimet e Inspektorëve ve per zbatim te orarit të levizjes se qytetareve ne baze te numrit te parafundit personal.	Rregulloret Komunale dhe Planet Lokale për Trafik,Mbeturina, Efiq ienc të Energjisë.	Shefi i Sektorit për SHP dhe I	Kompanitë kontraktuese, etj	Janë formuar komisionet per mbikeqyrje te puneve nga kompanitë fituese të tenderëve , si dhe komisionet per pranim teknik te puneve, është berë vlerësimin i kryerjes së shërbimeve si për nga cilësia ashtu edhe nga respektimi i afatit të kontratave.

07	Koordinon punën e Inspektorëve dhe ndihmon në përgatitjen e planeve të veprimt.	Ligjet për Inspeksion	Shefi i Sektorit për SHP dhe I	Drejtorin e Drejtorisë, Inspektoret komunal	Është hartuar plani komunal i menaxhimit të mbeturinave komuna e junikut 2021-2024. Plani ne fjalë është miratuar nga Kuvendi Komunal.
08	Mirëmbajtja e Bazës së të dhënave të Drejtorisë përkatëse. Përgatitja e dokumentacionit për tenderim të projekteve.	Plani i Punës	Shefi i Sektorit për SHP dhe I	Drejtorin e Drejtorisë, Zyrën e prokurimit.	Është bërë mirëmbajtja e bazës së të dhënave të Drejtorisë për SHPIM&SH si dhe përgatitja e dokumentacionit për tenderim të projekteve me paramasa dhe paralogari deri më 04.06.2021.
	Raporti mujor për Zyrтарin kryesor Financiar për pagesat e pa paguara nga Drejtoria për SHPIM&SH.	Plani i Punës	Shefi i Sektorit për SHP dhe I	Drejtorin e Drejtorisë, Zyrтарin kryesor Financiar	Janë bërë 5 Raporte mujore për Zyrтарin Kryesor financiar për pagesat e pa paguara nga Drejtoria për SHPIM&SH. Nga 1 Janari deri me 31.05.2021 sipas raportit të Shefit të Drejtorise per SHPI dhe Zyrтарit të

					të Hyrave shuma e të hyrave nga taxa e Inspeksionit është 1150.00 Euro.
10	Barazimi i të hyrave për DSHPI&SH me Zyrtarin e të hyrave si dhe përgatitja e raporteve mujore të pagesave.	Plani i punës	Shefi i Sektorit për SHP dhe I	Drejtorin e Drejtorisë për SHPI&SH, Zyrtarin e të Hyrave	Është bërë Procesi i barazimit të të hyrave nga zyrtari i të hyrave si dhe Raporti vjetor i të hyrave në DSHPI&SH për periudhën 1 Janar deri me 31.05.2021 ,në vlerë prej 1150.00 €
11	Hartimi i Planeve Lokale dhe Rregullores për Shërbime Publike që kanë të bëjnë me lirin e Inspeksionit dhe Shërbimeve Publike Komunale.	Ligjet dhe Rregulloret Komunale	Drejtori i DSHPI&SH, Shefi i Sektorit për SHP dhe I		Janë hartuar Plane Lokale për Trafik dhe për Menaxhim të mbeturinave për vitin 2020 si dhe Implementimi i UA 06/2018 për ndëshkim me gjoba mandatorë.Plotesim ndryshimi i rregullores për Orarin e punës të subjekteve Afariste në K.Junik
12	Evidentimi i faturave të pagesave nga DSHPI&SH si dhe zotimi i mjeteve për pagesa.	Drejtori i DSHPI&SH, Shefi i Sektorit për SHP dhe I	Drejtori i DSHPI&SH, Shefi i Sektorit për SHP dhe I		Është bërë evidentimi i të gjitha pagesave si dhe zotimi i mjeteve për të gjitha pagesat në drejtori deri me 04.06.2021.

RAPORT I I PUNËS ME DETYRAT DHE AKTIVITETET E SHEFIT PER SHP DHE INSPEKSION PER PERIUDHEN 1 JANAR – 4 QERSHOR 2021

Komuna e Junikut ka një sipërfaqe prej 77,77 km², dhe 6084 banorë. Në komunën e Junikut janë tri vendbanime: Juniku dhe dy fshatra Gjocaj dhe Jasiq. Banoret e fshatrave Gjocaj dhe Jasiq që nga paslufta jetojnë në lagjen, Agim Ramadani”.

Nr.	Emertimi	vend parkingje		
2	Park.Publ.privat.	40		
3	Park te Stac.Autob.	10	5 perona	
4	parking	3 me aftësi te kufizuara		
5	Park.mbas QKMF	130		
6	Park.te tregu i gjelbert	20		
7	Park.te Valevica	140		
Gjithsej vendparkinge		373		

Ndërtimi i rrjetit sekondar të kanalizimit për ujërave të zeza gjatë Vitit 2018 dhe 2020	
Sipas kontratës me nr. identifikues: 636 18 5472 521	Janë ndërtuar 1550 m gjatësi, traseja e kanalizimit të ujërave të zeza neper lagjet e komunës së Junikut
Asfaltimi i rrugëve lokale në K. Junik	Janë ndërtuar 1040 m gjatësi, traseja e kanalizimit të ujërave të zeza gjatë asfaltimit të rrugëve lokale në Junik.
Asfaltimi i rrugëve lokale në lagjen Gaxherr me nr identifikues 636 18 2962 521	Janë ndërtuar 350 m gjatësi, traseja e kanalizimit të ujërave të zeza gjatë asfaltimit të rrugëve lokale në L. Gaxherr, pika 6.1 e paramases se kontratës me nr identifikues 636 18 2962 521 te datës 27.08.2018
Ndërtimi i rrjetit sekondar të kanalizimit për ujërave të zeza gjatë Vitit 2020	Janë ndërtuar 85 m gjatësi, traseja e kanalizimit të ujërave të zeza
Totali i gjatësisë së rrjetit të kanalizimit të ndërtuar	3025 m

Raportet mujore e të hyrave në Drejtorinë për SHPIM&SH për Vitin 2020

Rrugët e Asfaltuara Regjionale dhe Lokale në K. Junik në Vitin 2021

Nr.	Rrugë të asfaltuara	Gjatësia në km ¹	gjerësia në m	m ²
1	Rrugë Regjionale	12.3 km ¹	6 m ¹	73,800
2	Rrugë lokale deri me 2016	23.00 km ¹	5 m ¹	115.00
3	Rrugë lokale të shtrëna në 2017	10.12 km ¹	5 m ¹	50.600
4	Rrugë lokale të shtrëna në 2018	9.00 km ¹	5 m ¹	45.000
5	Rrugë lokale të shtrëna në 2020	3.850 km ¹	4.5 m ¹	
	Asfaltimi i rrugës Junik-Gjeravice	17.950 km ¹		Eshte ne proges
5	Gjithsej rrugë lokale	42.12 km ¹	5 m ¹	210,600
6	Trotuare	5.56 km ¹	1.20	6.672
7	Rrugë me ndriçim publik 2017	11.3 km ¹		-
8	Rrugë me ndriçim publik 2018	7.2 km ¹		
9	Hapja e rrugëve fushore 2020	13.5 km ¹	4-5 m ¹	60,75

10	Rrugë të shenjëzuara	26.50 km ¹	5 m ¹	132,500
----	----------------------	-----------------------	------------------	---------

SIGURIA

Raportet e vazhdueshme nga stacioni policor tregojn që gjendja në aspektin e sigurisë në komunën e Junikut është e shkëlqyeshme, si në dy muajt e parë të vitit, por edhe që nga konfirmimi i rastit të parë me Covid-19 në vend, mirëpo ka pasur shënim të rritjes së numrit të rasteve të dhunës në familje si pasojë e pandemisë, megjithatë organet e sigurisë dhe rendit si dhe Qendra për Punë Sociale në komunën e Junikut kanë bërë përpjekje maksimale që çdo problematik komunitare të trajtohet me delikates dhe qytetarëve të iu ofrohen klimë e mirë dhe e sigurt për jetes.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE DHE BALLAFAQIMI ME PANDEMIN GLOBALE COVID-19

Komuna e Junikut që nga konfirmimi i rastit të parë në vend është mobilizuar në menaxhimin e Pandemisë COVID-19, ku menjëher ka formuar Shtabin Emergjent Komunal të kryesuar nga kryetari i komunës, i përbërë nga drejtor, zyrtarë me impakt në zhvillimet komunale dhe komunitet, kryeshefi i QKMF-së, komandati i Policisë, përfaqësuesi i bizneseve dhe përfaqësuesi i komunitetit fetar.. Komuna e Junikut në vazhdimësi ka sensibilizuar qytetarët për respektimin e rregullave të mbrojtjes dhe vaksinim.

LISTA E PROJEKTEVE INVESTUESE GJATË PERIUDHËS JANAR-QERSHOR

Pavarësisht situatës epidemiologjike komuna e Junikut ka vazhduar zhvillimin e projekteve investuese edhe pse Qeveria Kurti nga shumë projekte kapitale ka reduktuar mjetet financiare, por komuna përkundër vështirësive financiare po vazhdon zhvillimin e këtyre projekteve:

- Ndërtimi i Shtratit të lumit Erenik –Faza IV,
- Asfaltimi i Rrugeve Lokale,
- Ndërtimi i Qendrës së Kulturës, Rinisë dhe Bizneseve,
- Ndërtimi i Memorialit të Deshmoreve,
- Ndërtimi i shkollës fillore “Edmond Hoxha”,
- Vax=zhdojne punimet ne Asfaltimin e Rruges Junik – Jasiq – Gjocaj,
- Pritet të filloj Ndërtimi i Kendeve të Lojërave,
- Gjatë pushimit veror do rregullohet infrastruktura sanitare në të dy shkollat,
- Shkollat janë furnizuar me lëndë djegëse për nxehmje,
- Vazhdon hapja e rrugëve fushore,

TË TJERA

Komuna e Junikut ka mbajtur dy dëgjime publike me qytetar dhe nëse vazhdon ky trend I zhvillimit të pandemisë priten të mbahen dëgjime të tjera online, por si mundësi e mirë e komunikimit interaktiv online qytetar-zyrtar komunal është platforma digjitale e cila është funksionalizuar në fillim të vitit 2020 .

Agron Kuçi

Kryetar i Komunës